

UDHËZIM

Nr. 1, datë 01.10.2025

**PËR
MËNYRAT, STRUKTURËN, PERIODICITETIN DHE TREGUESIT E
VLERËSIMIT TË RAPORTEVE TË CILËSISË PËR TË DHËNAT E
TRANSMETUARA NË BAZË TË RREGULLORES (BE) NR. 549/2013 TË
PARLAMENTIT EVROPIAN DHE TË KËSHILLIT¹**

Bazuar në ligjin nr. 30/2022 “Për miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022-2026, nenet 17/4 dhe 20/b të ligjit nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”, Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024-2026, miratuar me vendimin nr. 16, datë 11.01.2024 “Për Miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024-2026”,

UDHËZOJ

1. Përcaktimin e mënyrave, strukturën, periodicitetin dhe treguesit e vlerësimit të raporteve të cilësisë për të dhënat e transmetuara në bazë të Rregullores (BE) nr. 549/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij udhëzimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Prodhimit Statistikor për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI PËRGJITHSHËM

Elsa Dhuli



¹ Ky udhëzim është përafuar plotësisht me:

Rregulloren zbatuese (BE) 2016/2304 të Komisionit 19 Dhjetor 2016 mbi mënyrat, strukturën, periodicitetin dhe treguesit e vlerësimit të raporteve të cilësisë për të dhënat e transmetuara në bazë të Rregullores (BE) nr. 549/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, CELEX 32016R2304.

Translation for EU Law: 2016/2304

CELEX: 32016R2304

Neni 1

Raporti i cilësisë mbi llogaritë kombëtare dhe rajonale i përmendur në nenin 4(2) të Rregullores (BE) Nr. 549/2013 duhet të mbulojë të dhënat e dërguara nga Shtetet Anëtare në përputhje me programin e transmetimit ESA 2010 siç përcaktohet në Aneksin B të Rregullores (BE) Nr. 549/2013 në vitin paraardhës të raportit.

Neni 2

Modalitetet, struktura dhe treguesit e vlerësimit të raporteve të cilësisë mbi llogaritë kombëtare dhe rajonale të përmendura në nenin 1 duhet të jenë ato të përcaktuara në Aneks.

Neni 3

Kjo Rregullore do të hyjë në fuqi në ditën e njëzetë pas publikimit të saj në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian. Kjo Rregullore do të jetë e detyrueshme në tërësinë e saj dhe do të zbatohet drejtpërdrejt në të gjitha Shtetet Anëtare.

ANEKS

Mënyrat, struktura dhe treguesit e vlerësimit të raporteve të cilësisë që do të paraqiten nga Shtetet Anëtare

1. Hyrje

Raporti i cilësisë për llogaritë kombëtare dhe rajonale duhet të përmbajë si tregues sasiore, ashtu edhe përshkrime cilësore mbi cilësinë e të dhënave të transmetuara një vit më parë. Komisioni (Eurostat) do t'u japë Shteteve Anëtare rezultatet e treguesve sasiore, të llogaritur mbi bazën e të dhënave të dorëzuara. Shtetet Anëtare duhet t'i interpretojnë dhe komentojnë ato, në përputhje me metodologjinë e tyre të përpilimit dhe procesin e prodhimit statistikor.

2. Mënyrat

- Para datës 15 shkurt 2017 dhe çdo vit pas kësaj date, Komisioni (Eurostat) do t'u dërgojë Shteteve Anëtare dokumente të draftuara për raportet e cilësisë, të paraplotësuara pjesërisht me të gjithë treguesit sasiore të përcaktuar në seksionin 4.
- Çdo vit, jo më vonë se 31 Maj, Shtetet Anëtare duhet t'i dorëzojnë Komisionit (Eurostat) raportin e plotësuar të cilësisë.

3. Struktura

Çdo Shtet Anëtar duhet të paraqesë një raport të vetëm të cilësisë, që mbulon të gjitha tabelat e programit të transmetimit ESA 2010, siç përcaktohet në Aneksin B të Rregullores (BE) nr. 549/2013.

Raportet e cilësisë duhet të përfshijnë informacion mbi të gjitha kriteret e cilësisë të përcaktuara në nenin 12(1) të Rregullores (KE) nr. 223/2009. Ky informacion duhet të paraqitet sipas strukturës së mëposhtme:

- Rëndësia
- Saktësia dhe besueshmëria
- Afatet kohore dhe përpikmëria
- Aksesueshmëria dhe qartësia
- Koherenca dhe krahasueshmëria

Informacioni mbi zbatimin e ESA 2010 që është dhënë tashmë nga Shtetet Anëtare do të ripërdoret nga Komisioni dhe nuk do të kërkohet sërish në raportet e cilësisë.

4. Vlerësimi i treguesve

4.1 Tregues sasiore

Raporti i cilësisë duhet të përmbajë treguesit sasiore të mëposhtëm:

Nr	Indikatori	Përkufizim (*)	Variabli dhe/ose tabela e ESA 2010 Programi i transmetimit	Periudha Referencë (*)	Kriteri i cilësisë	Zbatimi duke filluar nga:
1.	Shkalla e plotëshmërisë së të dhënave	Raporti ndërmjet numrit të të dhënave në tabela, të dërguara nga shtetet anëtare, me numrin e të dhënave në tabela, të kërkuara nga Programi i Transmetimit ESA 2010 që nuk përfshin të dhënat për të cilat ka përjashtim të përkohshëm (derogations - eng).	Të gjitha tabelat, në terma tremujore dhe vjetore.	1995 e në vazhdim Dhe në frekuencë tremujore	Rëndësia	2017
2.	Shkalla e rishikimit të të dhënave tremujore	Shkalla e rishikimit për variablat kryesore në terma tremujore, ndërmjet transmetimit të parë dhe atij më të fundit, si dhe norma mesatare e rishikimit në transmetimet pasuese që nga transmetimi i parë.	Produkti i Brendshëm Bruto në volum, i përshtatur sezonalisht dhe sipas kalendarit (Table 1) Punësimi gjithsej, në mijë persona, i përshtatur sezonalisht, (Tabela 1)	Të dhënat në terma tremujore të tre viteve të fundit	Saktësia dhe besueshmëria	2019
			Të ardhurat e disponueshme bruto të familjeve dhe institucioneve jofitimprurëse në shërbim të familjeve, të pa përshtatura sezonalisht (Tabela 801)			2021
			Shpenzimet për konsum përfundimtar të familjeve dhe institucioneve jofitimprurëse në shërbim të familjeve, të pa përshtatura sezonalisht (Tabela 801)			2021
			Vlera e shtuar bruto e korporatave jo-financiare, e pa përshtatur sezonalisht (Tabela 801)			2021
			Formimi bruto i kapitalit fiks i korporatave jo-financiare, i pa përshtatur sezonalisht (Tabela 801)			2021

Nr	Indikatori	Përkufizim (*)	Variabli dhe/ose tabela e ESA 2010 Programi i transmetimit	Periudha Referencë (*)	Kriteri i cilësisë	Zbatimi duke filluar nga:
3.	Norma e rishikimit të të dhënave në terma vjetore	Normat mesatare të rishikimit për variablat kryesore në terma vjetore në transmetimet pasuese pas transmetimit të parë	Tabela 1: Produkti i Brendshëm Bruto (në çmime korente dhe të vitit të mëparshëm), Vlera e shtuar bruto (në çmime korente) Tabela 1 (çmime korente): Kompensimi i punonjësve, Fitimi operativ bruto dhe të ardhurat mikse bruto Tabela 1 (çmime korente): • Shpenzimet për konsum përfundimtar të familjeve dhe institucioneve jofitimprurëse në shërbim të familjeve; • Shpenzimet për konsum përfundimtar të qeverisë; • Formimi bruto i kapitalit fiks; • Eksportet e mallrave dhe shërbimeve; • Importet e mallrave dhe shërbimeve; Tabela 1 (në mijë persona): • Punësimi gjithsej • Numri i Punonjësve Tabela 2 (çmime korente): • Shpenzimet e qeverisë • Të ardhurat e qeverisë Tabela 7 (çmimet korente): • Detyrimet gjithsej të sektorit financiar (jo të konsoliduara) Tabela 7 (çmimet korente): • Borxhi i korporatave jo-financiare (i konsoliduar) Tabela 7 (çmimet korente): • Borxhi i familjeve dhe institucioneve jofitimprurëse në shërbim të familjeve (i konsoliduar) Tabela 10: • Vlera e shtuar bruto me çmimet korente, punësimi në persona (t + 12 muaj) Tabela 10: • Kompensimi i punonjësve në çmime korente (t + 24 muaj) (NUTS 2 (1)) Tabela 13 (çmimet korente): • Të ardhurat neto të disponueshme të familjeve (NUTS 2)	Pesë vitet e fundit	Saktësia dhe besueshmëria	2019

Nr	Indikatori	Përkufizim (*)	Variabli dhe/ose tabela e ESA 2010 Programi i transmetimit	Periudha Referencë (*)	Kriteri i cilësisë	Zbatimi duke filluar nga:
4.	Përpikmëria - datat e transmetimit	Data e parë e transmetimit dhe data e transmetimit të të dhënave të verifikuara për secilën tabelë të programit të transmetimit ESA 2010, për të gjitha transmetimet që duhej të bëheshin gjatë vitit të fundit.	Të gjitha tabelat, në terma tremujore dhe vjetore	Viti më i fundit	Afatet kohore dhe përpikmëria	2017
5.	Përputhshmëria e të dhënave brenda tabelave dhe ndërmjet tabelave.	Mesatarja dhe diferenca maksimale absolute që tregon shkallën në të cilën statistikat janë të qëndrueshme brenda një grupi të caktuar të dhënash, pra, të gjitha identitetet e duhura aritmetike dhe kontabël janë të respektuara, nuk ka ndryshime të paqarta dhe janë të qëndrueshme me rregullat e integritetit.	Produkti i Brendshëm Bruto çmime korente (të dhëna tremujore dhe vjetore) Brenda Tabelës 1 (Produkti i Brendshëm Bruto sipas metodës së prodhimit, shpenzimeve dhe të të ardhurave) Vlera e shtuar bruto me çmime korente (të dhëna vjetore): • Midis tabelës 1 dhe 3 Kompensimi i punonjësve, me çmime korente (të dhëna vjetore): • Midis tabelës 1 dhe 3 Formimi bruto i kapitalit fiks me çmime korente (të dhëna vjetore): • Midis tabelës 1 dhe 3 dhe tabelës 1 dhe 22 Eksportet e mallrave dhe shërbimeve me çmime korente (të dhëna tremujore dhe vjetore): • Brenda tabelës 1 (nxjerrë nga komponentët e shpenzimeve të Produkti të Brendshëm Bruto dhe nga detajimi i eksportit) Importet e mallrave dhe shërbimeve me çmime korente (të dhëna tremujore dhe vjetore): • Brenda tabelës 1 (nxjerrë nga komponentët e shpenzimeve të Produkti i Brendshëm Bruto dhe nga detajimi i importit) Punësimi gjithsej, numri i punonjësve dhe numri i të vetëpunësuarëve (të dhëna vjetore, në mijë persona): • Midis tabelës 1 dhe 3	Pesë vitet e fundit	Koherenca dhe krahasueshmëria	2017
6.	Përputhshmëria e të dhënave në terma vjetore me shumën e të dhënave në terma tremujore	Shkalla në të cilën statistikat vjetore dhe tremujore janë të përputhshme	Për të gjitha variablat përveç punësimit, përputhshmëria testohet midis të dhënave vjetore dhe shumës së të dhënave të katër tremujorëve; për punësimin krahasohen të dhënat në terma vjetore me mesataren e të katër tremujorëve. Produkti i Brendshëm Bruto, çmimet korente, të dhëna jo të përshtatura sezonalisht (tabela 1) Punësimi gjithsej, në mijë persona, të dhëna jo të përshtatura sezonalisht	Pesë vitet e fundit	Përputhshmëria dhe krahasueshmëria	2017

Fletore Zyrtare e Komunitetit Evropian						
		(tabela 1) Fitimi operativ bruto për sektorin e korporatave jo-financiare (tabelat 8/801, çmime korente) Të ardhurat bruto të disponueshme për sektorët e familjeve dhe institucioneve jofitimprurëse në shërbim të familjeve (tabelat 8/801, çmimet korente)				
7.	Përputhshmëria e shumës gjithsej me shumën e komponentëve	Shkalla në të cilën shuma e komponentëve është e barabartë me shumën gjithsej	Produkti i Brendshëm Bruto, çmimet korente, të dhëna jo të përshtatura sezonalisht, shuma gjithsej dhe shuma e komponentëve të shpenzimeve (të dhëna tremujore dhe vjetore), tabela 1 Vlera e shtuar bruto në çmime korente, shuma gjithsej dhe ndarjet sipas NVE Rev. 2, niveli A10 (të dhëna tremujore dhe vjetore), tabela 1 Punësimi gjithsej në mijë persona, të dhëna jo të përshtatura sezonalisht, shuma gjithsej dhe shuma e numrit të punonjësve dhe të vetëpunësuarve (të dhëna tremujore dhe vjetore), tabela 1 Punësimi gjithsej, në mijë persona, shuma gjithsej dhe shuma sipas ndarjes NVE Rev. 2, niveli A10 (të dhëna vjetore), tabela 1	Pesë vitet e fundit	Përputhshmëria dhe krahasueshmëria	2017
8.	Përputhshmëria e agregateve kryesore me llogaritë jofinanciare sipas sektorëve	Dallimet midis të dhënave të agregateve kryesore dhe të dhënave përkatëse në llogaritë jofinanciare sipas sektorëve	Produkti i Brendshëm Bruto, çmimet korente, të dhëna jo të përshtatura sezonalisht (të dhëna tremujore dhe vjetore): • Midis tables 1 and 8/801 Shpenzimet për konsum final për sektorët e familjeve dhe institucioneve jofitimprurëse në shërbim të familjeve, çmime korente, jo të përshtatura sezonalisht (të dhëna tremujore dhe vjetore): • Midis tables 1 and 8/801 Formimi bruto i kapitalit fiks, cmime korente (të dhëna vjetore) • Midis tables 1 and 8/801 Kompensimi i punonjësve, cmime korente (të dhëna vjetore) • Midis tables 1 and 8/801	Pesë vitet e fundit	Koherenca dhe krahasueshmëria	2021

Nr	Indikatori	Përkufizim (*)	Variabli dhe/ose tabela e ESA 2010 Programi i transmetimit	Periudha Referencë (*)	Kriteri i cilësisë	Zbatimi duke filluar nga:
9.	Përputhshmëria e agregateve kryesore me llogaritë rajonale	Dallimet midis të dhënave të agregateve kryesore dhe të dhënave përkatëse në llogaritë rajonale	Vlera e shtuar bruto, çmimet korente (të dhëna vjetore): • Midis totalit të tabelës 1 dhe shumës së rajoneve NUTS 2 në tabelat 10 dhe 12 Punësimi në mijë persona (të dhëna vjetore): • Midis totalit të tabelës 1 dhe shumës së rajoneve NUTS 2 në tabelat 10 dhe 12	Pesë vitet e fundit	Koherenca dhe krahasueshmëria	2021
10.	Përputhshmëria e agregateve kryesore me tabelat e burim përdorimeve	Dallimet midis të dhënave të agregateve kryesore dhe të dhënave përkatëse në tabelat e burim përdorimeve	(Të gjitha të dhënat në çmime korente, të dhëna vjetore) Vlera e shtuar bruto: • Midis tabelave 1 dhe 16 Taksa minus subvencione mbi produktet: • Midis tabelave 1 dhe 15 Shpenzimet për konsum final, shpenzimet për konsum final të familjeve, shpenzimet për konsum final të qeverisë së përgjithshme, shpenzimet për konsum final të institucioneve jofitimprurëse në shërbim të familjeve: • Midis tabelave 1 dhe 16 Formimi i kapitalit bruto, formimi bruto i kapitalit fiks, ndryshimet në inventarë, blerjet neto të sendeve me vlerë: • Midis tabelave 1 dhe 16 Eksportet e mallrave dhe shërbimeve: • Midis tabelave 1 dhe 16 Importet e mallrave dhe shërbimeve: • Midis tabelave 1 dhe 15 Kompensimi i punonjësve: • Midis tabelave 1 dhe 16 Fitimi operativ bruto dhe të ardhurat mikse bruto • Midis tabelave 1 dhe 16	Pesë vitet e fundit	Koherenca dhe krahasueshmëria	2021

Nr	Indikatori	Përkufizim (*)	Variabli dhe/ose tabela e ESA 2010 Programi i transmetimit	Periudha Referencë (*)	Kriteri i cilësisë	Zbatimi duke filluar nga:
11.	Përputhshmëria e agregateve kryesore me statistikat financiare të qeverisë	Dallimet midis të dhënave të agregateve kryesore dhe të dhënave përkatëse në statistikat financiare të qeverisë	(Të gjitha të dhënat në çmime korente): Shpenzimet për konsum individual (të dhëna vjetore): • Midis tabelave 1 dhe 2 Shpenzimet për konsum kolektiv (të dhëna vjetore): • Midis tabelave 1 dhe 2 Taksat mbi produktet (të dhëna vjetore): • Midis tabelave 1 dhe 9	Pesë vitet e fundit	Koherenca dhe krahasueshmëria	2021
12.	Përputhshmëria e llogarive jofinanciare sipas sektorëve dhe statistikat financiare të qeverisë	Diferencat midis të dhënave të llogarive jofinanciare sipas sektorëve dhe të dhënave përkatëse në statistikat financiare të qeverisë	Huadhënie neto dhe huamarrje neto, sektori i qeverisë, çmimet korente (të dhëna vjetore): • Midis tabelave 8 dhe 2	Pesë vitet e fundit	Koherenca dhe krahasueshmëria	2021
13.	Përputhshmëria e llogarive jofinanciare sipas sektorëve dhe llogaritë financiare sipas sektorëve	Diferencat midis të dhënave të llogarive jofinanciare sipas sektorëve dhe të dhënave përkatëse në llogaritë financiare sipas sektorëve	Huadhënie neto dhe huamarrje neto, të gjithë sektoret, çmimet korente (të dhëna vjetore): • Midis tabelave 8 dhe 6	Pesë vitet e fundit	Koherenca dhe krahasueshmëria	2019

(*) Përveçse specifikohet ndryshe, indikatorët sasiorë llogariten bazuar në versionin më të fundit të të dhënave të shteteve anëtare të publikuara në faqen e internetit të Eurostat-it.

(1) Rregullorja (KE) Nr. 1059/2003 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 maj 2003, për krijimin e një klasifikimi të përbashkët të njësive territoriale për statistika (NUTS) (Fletorja Zyrtare L 154, 21.6.2003, fq. 1).

(2) Rregullorja (KE) Nr. 1893/2006 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 20 dhjetor 2006, për krijimin e klasifikimit statistik të aktiviteteve ekonomike NACE Revizioni 2 dhe për ndryshimin e Rregullores së Këshillit (EEC) Nr. 3037/90 si dhe disa rregulloreve të tjera të BE-së mbi fusha statistikore specifike (Fletorja Zyrtare L 393, 30.12.2006, fq. 1).

4.2 Informacion cilësor

Raporti i cilësisë duhet të përmbajë informacionin cilësor të mëposhtëm:

Nr	Treguesi	Përkuftizimi	Kriteri i cilësisë	Zbatimi duke filluar nga:
1.	Politika e rishikimit të të dhënave	Metadatat mbi politikën e rishikimit të të dhënave të llogarive kombëtare që përmbajnë: - Lidhje me metadatat ekzistuese të publikuara në nivel kombëtar; - Informacione të shkurtra rreth rishikimeve benchmark dhe/ose rishikimeve rutinë dhe ndikimet e tyre në Produktin e Brendshëm Bruto.	Saktësia dhe besueshmëria	2017
2.	Dokumentimi i metodologjisë	Lista e botimeve kombëtare mbi burimet e të dhënave të përdorura dhe metodologjia e aplikuar, duke përfshirë titujt e këtyre botimeve dhe lidhjet me to, nëse janë të disponueshme.	E drejta e hyrjes dhe qartësia	2017
3.	Gjatësia e serive kohore të krahasueshme	Metadatat mbi shtrirjen e serive kohore të krahasueshme gjatë kohës, që përmbajnë: - Lidhje me metadatat ekzistuese të publikuara në nivel kombëtar; - Informacione të shkurtra mbi shtrirjen e serive kohore të krahasueshme, ndërprerjet në seritë kohore dhe shpjegime për ndërprerjet.	Koherenca dhe krahasueshmëria	2021